REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti

KOMUNA E PRIZRENIT
Opstina Prizren
Prizren Belediyesi

BUXHETI I KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2027

2026

BUXHETI I KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2027, PARASHIKIM PËR 2028 -2029

Procesi i hartimit të Projekt-Buxhetit 2027-2029

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 24, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nenet 7 dhe 8, si dhe Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke u bazuar në qarkoret 2027/01 dhe 2027/02 të lëshuara nga MFPT-ja dhe në Kornizën Afatmesme të Buxhetit 2027–2029, është hartuar Buxheti Komunal për vitet 2027–2029, të cilin Kryetari, pas shqyrtimit, ia propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Asamblesë Komunale për miratim final, në afatin e paraparë me ligj (30.09.2026).

Procesi i hartimit të buxhetit me të drejtë konsiderohet si njëri ndër proceset më të rëndësishme për një organizatë buxhetore, për faktin se nga ai proces hartohet buxheti si një ligj, i cili përmban planin e financimit të të gjitha shpenzimeve në kategoritë përkatëse.

Organizata jonë buxhetore (622) ka zhvilluar procesin e hartimit të buxhetit për vitet 2027–2029, në harmoni të plotë me udhëzimet e pranuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përmes Qarkoreve Buxhetore 2027/01 dhe 2027/02, si dhe në zbatim të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me qëllim që finalizimi i tij të jetë në përputhje me interesat e qytetarëve të komunës sonë, për aq sa kanë lejuar kufijtë e limituar të financimit.

Buxheti, përveç burimeve të financimit apo burimeve të bërjes së tij, përmban edhe projeksionet e shpenzimeve dhe prioritetet e qeverisë lokale, të shpërndara në pesë kategori ekonomike të shpenzimeve, si dhe në programet dhe nënpogramet e tij.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka hartuar qarkoret buxhetore bazuar në të dhënat e përcaktuara nga Komisioni i Granteve i cili ka mandatin e përcaktimit të vlerës së granteve duke zbatuar kriteret e përcaktuara, si: numri i popullsisë, numri i nxënësve, numri i pakicave kombëtare, etj.

Nga këto përcaktime të Komisionit të Granteve ka rezultuar se buxheti i organizatës sonë buxhetore për vitin 2027 do të ketë vlerën 79,118,940.00 €.

Njëri ndër segmentet më të rëndësishëm në procesin e hartimit të buxhetit është ai i përcaktimit të prioriteteve të përgjithshme zhvillimore. Vendosja e prioriteteve kërkon analizë dhe angazhim të qeverisë lokale, që së pari të identifikojë nevojat zhvillimore. Pra, është një segment tejet i rëndësishëm në kuadër të procesit buxhetor, andaj pikërisht për shkak të kësaj rëndësie që ka, Kryetari i Komunës i kushton shumë kujdes prioritetëve dhe kërkesave të qytetarëve.

Bazë e përcaktimit të prioriteteve janë nevojat e qytetarëve të komunës sonë, si dhe planifikimet zhvillimore të qeverisë lokale, të cilat janë në funksion të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve. Mbi bazën e këtyre nevojave, Kryetari i Komunës, së bashku me stafin e tij dhe në konsultim me qytetarët,

në varësi të mjeteve të disponueshme, ka përcaktuar prioritetet 2027–2029, me fokus ato të vitit fiskal 2027.

Kriter shumë i rëndësishëm është edhe identifikimi i nevojave duke parë gjendjen aktuale në terren, si në atë urbane, ashtu edhe në atë rurale, sa i përket investimeve në projektet infrastrukturore.

Komuna e Prizrenit, si mision të vetin, ka zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik sipas prioriteteve, duke siguruar ambient të sigurt dhe tërheqës për investitorët. Misioni i qeverisë komunale për periudhën afatmesme buxhetore është përshpejtimi i zhvillimit ekonomik, shtimi i mundësive për shkollim, avancimi në shërbimet shëndetësore, kulturë, rini dhe sport, në lëmin e bujqësisë, si dhe zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit dhe infrastrukturës komunale, si çështje më kryesore që mund të ndikojnë në përmirësimin e shpejtë të gjendjes ekonomike dhe shoqërore të banorëve të komunës.

Ndonëse komuna nuk udhëheq drejtpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e nivelit qendror), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale. Buxheti Komunal i Prizrenit është në përputhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës dhe me kornizën makroekonomike të Kosovës, sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2025–2027 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Sipas Qarkores së pare buxhetore nr. 2027/01 për komuna, të datës 15.05.2026, dhe në bazë të shënimeve statistikore të regjistrimit të fundit të popullsisë së Kosovës të vitit 2024, rezulton se Komuna e Prizrenit ka 147,246 banorë (30,505 më pak banorë se në regjistrimin e vitit 2011), dhe nga Komisioni i Granteve – MFPT, për vitin 2027, komunës sonë i është ndarë Grant Qeveritar në vlerë 62,279,445.00 €.

Tabela nr. 1. Krahasimi i Buxhetit 2025/2026

Nr.	Përshkrimi	Vlera
1	Buxheti komunal 2026 (aktual)	**75,645,313.00**
2	Buxheti 2027	**79,118,940.00**
	Ndryshimi	**+ 4,073,628.00**

Bazuar në tabelat e buxhetit komunal nga vitet e kaluara dhe me qëllim të vazhdimit të reformave në procesin buxhetor, buxheti komunal për vitin 2027 është planifikuar dhe pasqyrohet sipas strukturës bazë të programeve dhe nënprogrameve buxhetore. Për të përmirësuar gjithëpërfshirjen, transparencën dhe kredibilitetin në formulimin e buxhetit komunal, synohet që hartimi i buxhetit të ndërtohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Prioritet për financim kanë projektet që janë në vazhdim, që kanë filluar në vitet e mëparshme, gjatë këtij viti, si dhe ato që janë në harmoni me prioritetet e Komunës.

Burimet e financimit komunal për vitin 2027


Financimi komunal përbehet nga: Granti i përgjithshëm, granti specifike për arsim para universitar, grantit specifik për shëndetësi primare, grantet për kompetencat e shtuara, të hyrat vetanake të komunave, grantet e donatorëve dhe financim nga huamarrja.

Sipas Qarkores se parë dhe të dyte buxhetore të lëshuar nga ana e MF-it për periudhën 2027-2029 për Komunën e Prizrenit është caktuar limitet e shpenzimeve 3 vjeçare si në tabelën 2.

Tabela nr.2. Burimet e financimit komunal për vitet: 2027-2029

	Burimet e financimit	2026	2027	2028	2029
		Aktual	Vlerësuar	Vlerësuar	Vlerësuar
1	Granti i Përgjithshëm	31,387,250.00	34,378,718.00	36,988,908.00	39,918,714.00
2	Granti specifik i Arsimit	22,967,574.00	22,842,065.00	23,527,327.00	24,233,147.00
3	Granti specifik i Shëndetësisë	6,904,266.00	7,326,116.00	7,545,900.00	7,772,277.00
4	Qendra kulturore Historike të fshatit Zym	59,802.00	60,101.00	60,101.00	60,101.00
5	Financimi për teatro	330,553.00	349,235.00	368,443.00	388,708.00
6	Financimi për shërbimet sociale edhe rezidenciale	630,000.00	630,000.00	615,000.00	615,000.00
7	**Grantet**	62,279,445.00	65,586,235.00	69,105,679.00	72,987,947.00
8	Të hyrat vetanake komunale	11,365,868.00	11,532,705.00	11,915,228.00	12,537,451.00
9	Huamrrja për efiqiencë të enërgjisë	1,400,000.00	2,000,000.00		
TOTALI:		**75,045,313.00**	**79,118,940.00**	**81,020,907.00**	**85,525,398.00**

Burimi: Qarkorja Buxhetore 2027/1 dhe 2027/02, MFPT 2026



Parashikimi i të hyrave vetanake komunale 2027-2029

Përveç granteve të marra nga niveli qendror, për qëllimet e mbulimit të shpenzimeve të përgjithshme, komuna mbledh edhe të hyra vetanake. Të hyrat vetanake në Komunën e Prizrenit realizohen në bazë të Rregullores mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi Tatimin në Pronë, si dhe dispozitave të tjera ligjore që përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale, me të cilat komuna ka të drejtë të caktojë dhe të inkasojë të hyrat.

Bazën kryesore të hyrave komunale e përbën Tatimi në Pronë, të cilat të hyra duhet të shpenzohen ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim, etj.

Me Qarkoren Buxhetore nr. 2027/01, për Komunën e Prizrenit, për vitet 2027–2029, është përcaktuar plani i të hyrave vetanake si vijon:

- Viti 2027 ..... 11,532,705.00 €,
- Viti 2028 ..... 11,915,228.00 €,
- Viti 2029 ..... 12,537,451.00 €.

Parashikimi i shpenzimeve buxhetore për periudhën 2027-2029

Për të pasur një pasqyrë mbi shpenzimet buxhetore të Komunës së Prizrenit sipas kategorive ekonomike, në tabelën vijuese po paraqesim trendët e vlerësuara të shpenzimeve për periudhën 2027-2029.

Tabela 3. Kufijtë e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike të vlerësuar për: 2027– 2029

	Buxheti në kategorit e shpenzimëve	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	32,588,844.00	32,751,788.00	32,915,547.00
2	Mallra dhe shërbime	15,730,224.00	16,730,224.00	17,730,224.00
3	Shpenzime komunale	1,405,299.00	1,405,299.00	1,405,299.00
4	Subvencione dhe transfere	5,713,459.00	6,213,459.00	6,913,459.00
5	Shpenzime kapitale	23,681,115.00	23,920,137.00	26,560,869.00
	Totali:	**79,118,940.00**	**81,020,907.00**	**85,525,398.00**
	Numri i stafit	**3207**	**3207**	**3207**

Shpërndarja e Buxhetit komunal për periudhën 2027 – 2029, siç shihet edhe në tabelën e lartshënuar, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, është bërë komfor limiteve buxhetore të përcaktuara me Qarkoren e dytë buxhetore 2027/02, të datës 14.08.2026 të lëshuar nga MFPT.

Me parashikimin e Buxhetit Komunal për vitin 2027 për kategorinë e pagave dhe mëditjeve është parashikuar të ndahet shuma prej 32,588,843.00€. Me këtë shumë parashihet të sigurohen pagat për 3207 të punësuarve të Administratës Komunale si dhe pagesat e shtesave të asambliestëve dhe puna jashtë orarit në Administratën Lokale. Këto të dala marrin pjesë me 41.2 % në shumën totale të buxhetit komunal. Paga për vitin 2028 është (32,751,788.00€), dhe për vitin 2029 do të jetë (32,915,547.00€)

Për kategorinë mallra dhe shërbime për vitin 2026 ka qenë e planifikuar shuma prej 14,500,234 € kurse për vitin 2027 parashikohet shuma prej 15,730,224.00€, kurse për vitin 2028 (16,730,224.00€) dhe (17,730,224.00€) për vitin 2029.

Për kategorinë e Shpenzimeve Komunale për vitin 2026 ka qenë e ndarë shuma prej 1,069,493 €, kurse për vitet 2027 do te jete 1,405,299.00€, në vitin 2028 (1,405,299.00€) € dhe vitin 2029 (1,405,299.00€).


Në kategorinë e subvencioneve shuma e planifikuar për vitin 2027 do të jetë: 5,713,459.00€ , ndërsa për vitin 2028 (6,213,459.00€) dhe në 2029 do të jete në vlere prej (6,913,459.00€).

Për realizimin e projekteve kapitale të projektuara në nivel të Komunës për vitin 2027 janë planifikuar 23,681,115.00€ (në këtë shumë është e llogaritur edhe Huaja prej 2 mil), për vitin 2028 është parashikuar shuma prej (23,920,137.00€) dhe për vitin 2029 është (26,560,869.00€) .

Totali i të dalave të parashikuara të buxhetit Komunal për vitin 2027 është prej 79,118,940.00€, ndërsa për vitin 2028 është 81,020,907.00€ dhe 85,525,398.00€ për 2029.

Struktura e Buxhetit për vitin 2027

Paga dhe mëditje	32,588,844.00	41.20%
Mallra dhe shërbime	15,730,224.00	19.90%
Shpenzime komunale	1,405,299.00	1.80%
Subvencione	5,713,459.00	7.20%
Investime kapitale	23,681,115.00	29.90%
TOTALI	**79,118,940.00**	100.00%



_____

Kryetari i Komunës së Prizrenit
z. Shaqir Totaj

_____

Drejtori për buxhet dhe financave

_____

Udhëheqesi i sektori për buxhet